



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

KOSOVA

PROFILI I MIGRIMIT

2015

AUTORITETI QEVERITAR PËR MONITORIMIN E LËVIZJEVE TË
MIGRIMIT

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, kopjohet ose transmetohet në çfarëdo lloj forme apo me çfarëdo mjeti, elektronik ose mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, incizimin, apo ndonjë grumbullim tjetër të informacionit dhe sistemit të korigjimit (rikthim), pa lejen e të drejtës të autorëve-Autoriteti Qeveritar për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit - Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kontakti:

Zyra për Komunikim Publik

Tel: + 381 (0)38 200 19 545

Email: zip-mpb@rks-gov.net

Adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n.

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,

ku mund të qaseni përmes ueb faqes së MBP

në internet: <http://mpb-ks.org/>

Qëllimi i profilit të migrimit 2015

Profili i Migrimit 2015 është i pari i këtij lloji që është hartuar nga Autoriteti Qeveritar për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit dhe me mbështetjen e koordinatorit nacional për migrim, Ministria e Punëve të Brendshme, si mekanizëm shtetëror i themeluar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky dokument është hartuar duke përcjellë metodologjinë dhe formatin e vendosur nga ICMPD në kuadër të Procesit të Pragës, një iniciativë në të cilën edhe Republika e Kosovës është anëtare.

Ky dokument është i versionit të shkurtër, apo siç njihet në terminologji si *Profil i Lehtë i Migrimit* (Light Migration Profile) dhe përmban të dhënat kryesore që lidhen me aspektet e menaxhimit të migrimit, në përputhje me tabelën e përmbajtjes si më poshtë.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë një pasqyrë informuese dhe analitike për institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe, në veçanti për vendimmarrësit, në mënyrë që të gjeturat nga ky dokument të artikulohen në politika shtetërore dhe në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuar në kuadër të *Strategjisë Shtetërore për Migrim* dhe *Planit të Veprimit 2013-2018*, si dhe dokumenteve tjera qeveritare strategjike që merren me çështjet e migrimit dhe zhvillimit të vendit.

Përmbajtja

Qëllimi i profilit të migrimit 2015.....	2
1. Informatat e përgjithshme të shtetit	5
1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje kufitare dhe gjatësia e kufijve	5
1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin	6
2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e imigrimit dhe emigrimit.....	7
2.1. Rrjedhat e migrimit dhe stoqet e migrimit.....	7
3. Migrimi legal me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore	10
3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse	10
3.2. Politikat.....	10
3.3. Statistikat.....	11
4. Migrimi i parregullt në vend.....	14
4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse	14
4.2. Politikat.....	14
4.3. Statistikat.....	15
4.3.1. Imigrimi i parregullt.....	15
4.3.2. Emigrimi i parregullt.....	16
4.3.3. Trafikimi me qenie njerëzore	17
5. Kthimi, ri pranimi dhe ri integrimi	19
5.1. Kthimi	19
5.1.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	19
5.1.2. Politikat	19
5.1.3. Statistikat	19
5.2. Ri pranimi	20
5.2.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	20

5.2.2.	Politikat	21
5.2.3.	Statistikat	21
5.4.	Ri integrimi.....	23
5.4.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse.....	23
5.4.2.	Politikat	24
5.4.3.	Statistikat	25
6.	Integrimi	28
6.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse	28
6.2.	Politikat.....	28
6.3.	Statistikat.....	29
7.	Migrimi dhe zhvillimi	31
7.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse	31
7.2.	Politikat.....	31
7.3.	Statistikat.....	32
8.	Azili dhe mbrojtja ndërkombëtare	35
8.1.	Autoritetet shtetërore përgjegjëse	35
8.2.	Politikat.....	35
8.3.	Statistikat.....	36
9.	Shtojcat	38

1. Informatat e përgjithshme të shtetit

1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje kufitare dhe gjatësia e kufijve



Rajoni: Evropa Jugore

Gjerësia: 41° 51' 21 dhe 43° 16'

Gjatësia : 19° 59' dhe 21° 47'

Emri zyrtar: Republika e Kosovës

Kryeqyteti: Prishtina

Gjatësia e kufijve: Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim 113.551 km, Republikën e Maqedonisë në jug 170.772 km, Republikën e Malit të Zi në veri-perëndim 79.165 km, Republikën e Serbisë në veri-lindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror¹.

Sipërfaqja: 10,908 km²

Gjatësia e përgjithshme e kufirit: 743. 556 km

Vendet fqinje: Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë

¹ STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/ALB_Strategjia_Kombetare_MIK_2013-2018_12.07.2013.pdf

² Po aty.

Popullsia: 1,771,604 (2015 e vlerësuar)

Dendësia e popullsisë: 162 banorë në 1km² Grupet etnike: Shqiptarë 91.1%; të tjerë 9.9% (2015)

Forma e qeverisjes: Republikë Parlamentare

Valuta: Euro (EUR)

Dita e pavarësisë: 17 Shkurt, 2008

Presidenti: z. Hashim Thaçi

1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin

Republika e Kosovës është shtet me demokraci (parlamentare) të bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

Kompetencat administrative në fushën e migrimit dhe azilit janë të ndërthurura në mes të pushtetit qendror (ministrive përkatëse) dhe nivelit e autoriteteve komunale.

Sistemi për menaxhimin e migrimit në Kosovë bazohet në rregullativën ligjore³ dhe institucionale. Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni kryesor që merret me çështjet e azilit, të huajve, çështjet e shtetësisë dhe ri integrimin e personave të riatdhesuar. Institucionet e tjera që kanë përgjegjësi në çështjet e migrimit janë ato, si: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Diasporës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (përfshirë nivelin komunal, si Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit Evropian, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil.

.....
³Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt, Ligji Nr.04/L-217 për Azil, Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Ligji Nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji nr.04/l-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligji Nr.04/l-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji Nr.03/L-208 për Ripranim, Ligji Nr.04/L-076 për Policinë, Ligji nr.04/l-003 për Gjendjen Civile

2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e imigrimit dhe emigrimit

2.1. Rrjedhat e migrimit dhe stoqet e migrimit

Viti 2015 vlerësohet të jetë një ndër vitet me së shumti emigrantë ndërkombëtar të regjistruar që ishin larguar nga Kosova. Ky emigrim, kishte përfshirë kryesisht grup moshat e reja, por, në një masë të caktuar edhe grup moshat e tjera (emigrim familjar). Në kontekstin etnik, më së shumti kishte prekur komunitetin shqiptar dhe atë rom, ashkali dhe egjiptian.

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2015, pa marrë parasysh statusin e qëndrimit (legal-illegal) apo qëllimin e emigrimit, është llogaritur të jetë 74,434 banorë, apo 4.2% e popullsisë rezidente në Kosovë. Numri i të kthyerve (imigrantëve kosovarë) gjatë vitit 2015 ishte 18,862 banorë⁴.

Për shkak të shkallës së lartë të emigrimit, përkundër asaj që Kosova kishte regjistruar një shtim natyror prej 22,232 (2015), popullsia e Kosovës u zvogëlua për 33,340 banorë. Numri i popullsisë rezidente në Kosovë, me 1 janar 2016, është vlerësuar të jetë 1,771,604 banorë.

Tabela 1. Indikatorët demografik për periudhën 2011-2015

Indikatorët demografik	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Rritja / zvogël.	Mesatarja
							2011-2015	
Popullsia	1,774,248	1,798,645	1,815,606	1,820,631	1,804,944	1,771,604	-27,041	-5,408
Nataliteti		34,101	27,650	29,723	32,087	31,116	154,677	30,935
Mortaliteti		7,622	7,287	8,317	8,165	8,884	40,275	8,055
Shtimi natyror		26,479	20,363	21,406	23,922	22,232	114,402	22,880
Shkalla e natalitetit		19.0	15.2	16.3	17.8	17.6	-1.4	17.2
Shkalla e mort.		4.2	4	4.6	4.5	5.0	0.8	4.5
Imigrimi		4,614	5,298	3,864	5,724	18,862	38,362	7,672
Emigrimi		6,695	8,700	20,246	45,333	74,434	155,408	31,082
Net migrimi		-2,081	-3,402	-16,382	-39,609	-55,572	-117,046	-23,409
Rritja absolute		24,398	16,961	5,024	-15,687	-33,340	-2,644	-529
Rritja në%		1.4	0.9	0.3	-0.9	-1.9	-0.20	-0.04
Urbane		38.3	38.6	38.9	39	38.9	0.6	38.7
Rurale		61.7	61.4	61.1	61.1	61.1	-0.6	61.3

⁴Agjencia e Statistikës së Kosovës " VLERËSIM: Popullsia e Kosovës 2015 Prishtinë, Qershor 2016: i <http://ask.rks-gov.net/sq/popullsia>

Mosha mesatare		30.2	30	30.6	30.8	30.2	-	30.5
Jetëgjatësia		76.7	76.7	76.8	76.8	76.7	-	76.7

Burimi: ASK

Lindjet e regjistruara/vlerësuara gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare ishin gjithsej 154,677 raste, derisa vdekje të regjistruara/vlerësuara prej 40,275 me një mesatare vjetore prej 30,935 lindjeve respektivisht 8,055 vdekje. Rritja e përgjithshme natyrore gjatë kësaj periudhe ishte prej 114,402 apo me një mesatare vjetore prej 22,880 banorëve.


Nëse do t'i kishim vë në raport indikatorët natyror (lindjet, vdekjet), me indikatorët mekanik (imigrimi, emigrimi), do të shohim se gjatë kësaj periudhe kemi një ngecje me tendencë zvogëlimi të popullsisë në aspektin e rritjes së përgjithshme të popullsisë së Kosovës.

Nga numri i përgjithshëm i lindjeve (154,677) dhe të emigruarave (155,408), shohim se kemi pasur më pak lindje se sa emigrim (-731 emigrantë) për periudhën në fjalë (bilanc negativ të shtimit të përgjithshëm të popullsisë).

Numri i të vdekurve (40,275) ishte më i lartë se numri i të kthyerve/imigrantëve (38,362) dhe në aspektin demografik nuk kishte as kompensim të thjeshtë demografik (-1,913 persona).


Përkundër një shtimi pozitiv natyror prej 114,402 të banorëve (2011-2015), migrimi neto prej -117,046 banorëve, ndikoi që popullsia e Kosovës për periudhën e caktuar të zvogëlohet për -2,644 banorë (popullsia me 1 janar 2011- popullsia me 1 janar 2016).

Figura 1. Raporti ndërmjet shtimit natyror dhe net migrimit 2011-2015



Burimi: ASK

Figura 2. Raporti ndërmjet shtimit natyror dhe net migrimit 2011-2015



Burimi: ASK

Migrimi neto, i shprehur gjatë vitit 2014 dhe 2015 (-95,181 banorëve) do të ketë ndikim direkt në shkallën e fertilitetit në vitet vijuese, ndërsa ka pasur efekt në ndryshimin e strukturës gjinore, moshës, jetëgjatësisë, shkallës së urbanizimit dhe tek indikatorët tjerë social ekonomik.

3. Migrimi legal me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore

3.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departament për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM)⁵ është autoritet shtetëror përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për leje të hyrjes dhe qëndrim në Republikën e Kosovës. DSHAM merr vendime lidhur me kërkesat për leje qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm, vendime lidhur me kërkesat për vazhdim të vizave, si dhe është pjesë e procesit vendimmarrës për lëshimin e vizës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale⁶, në lidhje me gjendjen në tregun e punës, përcakton kushtet e lejeve të punësimit dhe është përgjegjës për rregullat ligjore që rregullojnë punësimin e të huajve në raport me dispozitat ligjore përkatëse të Kosovës. Gjithashtu mban një regjistër me të gjithë aplikuesit. Zyrat e Punësimit monitorojnë hyrjet dhe daljet në tregun e punës për shtetasit e huaj.

3.2. Politikat

Korniza kryesore strategjike, e cila synon promovimin e migrimit të rregullt është *Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018*, objektivi i dytë (2), i kësaj strategjie, përcakton masat që kanë për qëllim përmirësimin e menaxhimit të migrimit ligjor dhe qarkullues.

Çështjet e imigrimit rregullohen me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, i cili ka hyrë në fuqi më 5 shtator 2013. Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjen, qëndrimin dhe punësimin e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Ligji për të Huajt përfshin të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me të huajt që nga hyrja, lëvizja si dhe qëndrimi i tyre në Republikën e Kosovës dhe i adresohet të gjitha institucioneve përkatëse që kanë të bëjnë me këtë fushë. Sipas Ligjit për të Huaj (Neni 37), ekzistojnë tri lloje të qëndrimit: qëndrimi deri në nëntëdhjetë (90) ditë, qëndrimi i përkohshëm dhe qëndrimi i përhershëm.

Republika e Kosovës, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ka hartuar *Planin Kombëtar* për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, në kuadër të secilës është paraparë ndryshimi-plotësim i Ligjit për të Huajt me qëllim të harmonizimit me Direktivat e BE-së, kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në suaza të transfereve brenda Korporatave, kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtor

⁵<http://mpb.rks-gov.net>
⁶<http://mpms.rks-gov.net>

sezoni si dhe llogaritja e afatit ku në Ligjin në fuqi për të Huajt, llogaritja e afatit bëhet në muaj, ndërsa Direktiva e përcakton se afati duhet të llogaritet në muaj⁷.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjatë ristrukturimit të saj, ka themeluar Divizionin për Shërbime të Migrimit, i cili do të funksionojë në kuadër të Agjencisë së Punësimit. Detyrat kryesore të këtij Divizioni janë ofrimi i shërbimeve informuese profesionale për migracion rreth punësimit. Gjatë vitit 2015 ka kryer procesin e konfirmimit për lëshimin e vërtetimit për shtetasit e huaj si dhe përcaktimin e kuotës vjetore sipas legjislacionit në fuqi, etj.

Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt⁸, ka përcaktuar kriteret për: Vërtetimin për punë, për lajmërimin e punës, si dhe angazhimin e të huajve në shërbimet në kohëzgjatje deri më 90 ditë brenda vitit kalendarik.

MPMS, përmes politikave të punësimit, synon krijimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet tjera, me qëllim të rritjes së punësimit. Gjatë vitit 2015 është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Qendrën për Përkujdesje të Personave të Moshuar me shtetin e Zvicrës. Marrëveshja e arritur është bërë për profesionin e *infirmierisë*, si punë praktike, ku gjate fazës së parë janë dërguar 7 persona me kohëzgjatje për 4 muaj.

3.3. Statistikat

Në vitin 2015 janë dhënë gjithsej 3444 leje qëndrime të përkohshme, ku prej tyre 49,9% për meshkuj, ndërsa 50,1% për femra.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, numri i të huajve me leje qëndrim të përkohshëm, për tre vitet e fundit, pasqyron rritje. Kështu që në vitin 2015, numri i të huajve me leje qëndrim të përkohshëm është më i madh për 30,3% krahasuar me vitin 2014, çka dëshmon së Kosova po bëhet edhe vend i destinacionit të migrimit legal.

Shtetet më të përfaqësuara në numrin e leje qëndrimeve të përkohshme të lëshuara janë: Turqia (25,9%), Shqipëria (23,0%), Serbia (11,4%), dhe shtetet tjera (39,7%).


Qëllimet kryesore për qëndrim të ligjshëm në Kosovë janë të lidhura me të drejtën e bashkimit familjar, punësim, studim dhe të tjera.

.....
⁷ Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si puntor sezonal.

Direktiva 2014/66 / EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadrin e një transferim ndër-korporatave

⁸ Udhëzimit Administrativ 01/2014 per Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit për Lajmërimin e Punës.

Figura 3. Lëshimi i Leje qëndrimeve të përkohshme sipas kategorive, 2013-2015



Burimi: DSHAM/MPB

Nga numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për leje qëndrim të përkohshëm, gjate vitit 2015, sipas kërkesave, struktura e leje qëndrimeve të dhëna është: për bashkimi familjar 1435 (41,7%), për punë 1565 (45,4%) për studime 187 (5,4%) dhe të tjera 257 (7,5%).

Përgjatë vitit 2015, për leje qëndrime të përhershme janë bërë gjithsej 68 kërkesa. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave për leje qëndrime të përhershme: 67 (98,5%) -vendime pozitive, 1 (1,5%) - numri i vendimeve pozitive pa caktim të kohëzgjatjes. Nga numri i përgjithshëm i leje qëndrimeve të përhershëm, 48 (70.5%) ishin meshkuj dhe 20 (29,5%) ishin femra.


Shtetet më të përfaqësuara për nga numri i dhënë të leje qëndrimeve të përhershme janë: Serbia (33,0%), Gjermania (21,0%), Maqedonia (9,0%), dhe shtetet e tjera (37,0%).

Në vitin 2015 janë dhënë 67 leje qëndrime të përhershme, kurse në vitin 2014 janë dhënë 77 leje qëndrime të përhershme, d.m.th, 15% më pakë krahasuar me vitin 2014.

Prodhimi i leje qëndrimeve për të huajt

Bazuar në të dhënat statistikore të Agjencisë së Regjistrimit Civil, lidhur me leje qëndrimet e përkohshme, gjatë vitit 2015 janë prodhuar 3,333 gjithsej (ku nga numri i përgjithshëm, 1,610 leje qëndrime janë të gjinisë mashkullore, kurse 1,723 të gjinisë femërore). Për dallim nga viti paraprak (2014), ku kishim 2,604 leje qëndrime të përkohshme të prodhuara (1,271 për meshkuj dhe 1,333 për femra), shihet se kemi rritje të pajisjes së qytetareve të huaj me leje qëndrime. Vlen të theksohet se gjinia femërore dominon edhe në këtë vit për nga numri i prodhimit të lejeve të qëndrimit të përkohshme.

Figura 4. Prodhimi I leje qëndrimeve të përkohshme dhe të përhershme 2013 - 2015



Burimi: ARC/MPB

Numri i leje qëndrimeve të përhershme të prodhuara ishte më i vogël për dallim nga leje qëndrimet e përkohshme, e që në total ishte 70. Prej tyre 52 ishin të gjinisë mashkullore, ndërsa 18 të gjinisë femërore. Për dallim nga viti paraprak numri i leje qëndrimeve të përhershme të shtypura është zvogëluar. Në vitin 2014, në total kishim 78 leje qëndrime të përhershme të prodhuara, nga to 44 të gjinisë mashkullore dhe 34 të gjinisë femërore.

4. Migrimi i parregullt në vend

4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Policia e Republikës së Kosovës/Departamenti i Policisë Kufitar⁹ është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Departamenti i Policisë Kufitare, në kundër të menaxhimit dhe kontrollimit të kufirit shtetëror merret edhe me parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt. Policia Kufitare e Republikës së Kosovës bashkëpunon dhe ndër vepron me Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila ka kompetencë në çështjet me azil, refugjatët dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës, me qëllim të arritjes së kontrollit dhe menaxhimit efektiv të migrimit të pa rregullt.

Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ)¹⁰, është drejtori e specializuar e Policisë së Kosovës, e ngarkuar me përgjegjësinë e hetimit të rasteve dhe veprave tjera që ndërlidhen me trafikimin me njerëz. DHTQNJ-ja është e strukturuar nën Divizionin Kundër Krimit të Organizuar brenda Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës.

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim është institucion përgjegjës për hartimin e politikave të migrimi, përfshirë migrimin e parregullt, çështjet e azilit dhe refugjatëve, si dhe është pjesë e zbatimit të politikave që ndërlidhen me imigrues të parregullt në Kosovë. DSHAM gjithashtu është pjesë e menaxhimit të: Qendrën për Azil-kërkues dhe Qendrën e Mbajtjes së të Huajve.

4.2. Politikat

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar kornizën ligjore dhe të politikave¹¹ për parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt, kontrabandimit me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Pasi që u evidentua një fluks i madh i njerëzve që po largohen nga Kosova përmes rrugëve të parregullta, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014 dhe tremujorin e parë të vitit 2015, institucionet e Republikës së Kosovës i bashkuan përpjekjet e tyre në parandalimin dhe luftimin e migracionit të parregullt.

⁹<http://www.kosovopolic.com/sq/departamenti-per-kufi>

¹⁰ <http://www.kosovopolic.com/sq/departamenti-i-hetimeve>

¹¹ Ligjin Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji N r. 04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, Kodi penali i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Vendimit i Qeveris së Republikës së Kosovës nr-15/158, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit 2013-2018; Ligji për parandalimin dhe luftimin trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit; Ligji për kompensimin e viktimave të krimit; Ligji për shëndetësi; Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe plani i veprimit 2015-2019; Strategjia e punës e DHTQNJ-së dhe plani vjetor i veprimit; Procedurat Standarde të veprimit për viktimat e trafikimit; Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit; Strategjia afatgjate për ri-integrimin e viktimave të trafikimit.

Me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt të qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës miratoi një Rezolutë në të cilën parashihen lehtësira doganore, tatimore dhe administrative për subjektet që ofrojnë punë për më shumë se 10 persona. Për më tepër, kjo rezolutë thekson së Qeveria e Kosovës planifikon të fillojë negociatat me vendet e BE-së në arritjen e marrëveshjeve për të siguruar punësim sezonal në SHA të BE-së për qytetarët e Kosovës. Gjithashtu, thuhet së gjykatat përmes procedurave të përshpejtuara duhet të zgjidhin rastet e trafikimit me njerëz. Vendimi i Qeverisë së 4 marsit 2015, për faljen e borxheve të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore deri më 31 dhjetor të vitit 2008, po ashtu ka për qëllim parandalimin e migrimit të parregullt, pasi që lehtëson problemet financiare me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës, duke pasur parasysh që faktori më i rëndësishëm i këtij fluksi të madh të emigrantëve është gjendja e rënduar ekonomike. Në këtë drejtim, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe MPMS kanë nënshkruar një marrëveshje, në bazë së cilës 900 persona të regjistruar në skemën e ndihmës sociale janë të punësuar sezonal në sektorin e pylltarisë.

Për më tepër, janë lansuar dhe intensifikuar fushatat për vetëdijesim në lidhje me rreziqet e migracionit të parregullt. Mesazhet e fushatës, jo vetëm që janë fokusuar në rreziqet dhe disavantazhet e ikjes nga Kosova, por edhe përfitimet nga qëndrimi dhe kërkimi i mundësive brenda vendit.

Si rezultat i të gjitha këtyre përpjekjeve dhe masave, fluksi i emigrantëve të parregullt nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së ka rënë në mënyrë drastike që nga muaji mars i vitit 2015, siç dëshmohet edhe nga statistikat e EUROSTAT mbi aplikimet për azil në këto shtete.

Duke parë trendët e lëvizjes së imigrantëve, në veçanti nga Siria në vendet e rajonit, por edhe në vendet e BE-së, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur Planin e Reagimit për menaxhimin e fluksit të mundshëm të refugjateve në Republikën e Kosovës.

4.3. Statistikat

4.3.1. Imigrimi i parregullt

Gjatë vitit 2015, 88 persona gjithsej e kanë kaluar kufirin në mënyrë të paautorizuar dhe kanë hyrë në territorin Republikës së Kosovës.

Tabela 2 .Kalimi i kufirit në mënyrë të paautorizuar, 2013-2015

Viti	2013	2014	2015
Numri i Personave	62	95	88

Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare, Njësia e Analizës së Rriskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave.

Nga 88 personat gjithsej, të cilët në mënyrë të paautorizuar kanë kaluar kufirin janë: 66 nga Siria, 7 nga Iraku, 6 nga India, 2 nga Palestina, 2 nga Irani, 2 nga Jordania, 1 nga Algjeria, 1 nga Maroku dhe 1 nga Turqia.

Po ashtu, gjatë vitit 2015, nga Departamenti i Policisë Kufitare janë iniciuar 4 raste për kontrabandë me imigrantë, ku janë arrestuar 6 persona (3 shtetas turq, 1 kosovar dhe 1 indian).

Numri i imigrantëve, të cilët e kanë përdorur Republikën e Kosovës si rrugë transiti ka qenë i vogël për arsye se shtetasit nga shtetet e Azisë dhe Afrikës kanë lëvizur në mënyrë të organizuar në grupe të mëdha njerëzish, kështu që, shtetet si: Greqia, Maqedonia e Serbia kanë hapur kufijtë që këta imigrant të lëvizin lirshëm drejt shteteve të BE-se. Gjatë vitit 2015, 3844 personave iu është refuzuar hyrja në territorin e Republikës së Kosovës.

Tabela 3. Refuzimi i hyrjes në kufi, 2013-2015

Viti	2013	2014	2015
Numri i Personave	1997	2827	3844

Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare, Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave

Nëse krahasojmë vitin 2015 me dy vitet paraprake, shohim së kemi një rritje për 35% me vitin 2014, ndërsa me vitin 2013 kemi një rritje për 92%. Në këtë rritje të refuzimit të hyrjeve ka ndikuar hyrja në fuqi e vendimit të qeverisë më nr. 15/158 për regjim të vizave, dhe angazhimet më të mëdha të Policisë Kufitare për të parandaluar hyrjen e të huajve, me qëllim që Kosova mos të shfrytëzohet si vend transit nga shtetasit e shteteve aziatike dhe afrikane, të cilët tentojnë të hyjnë në Republikën e Kosovës dhe pastaj të largohen përmes Serbisë dhe Malit të Zi për në shtetet e BE-se. Nga totali i personave të refuzuar në hyrje janë: 92% nga shtetet evropiane, 6% e personave të refuzuar janë nga shtetet aziatike, 1% e të refuzuarve janë nga shtetet afrikane dhe nga SHBA janë 0.4%.

Shtetasve të shteteve fqinje, si: Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi iu është refuzuar hyrja për mungesë të dokumenteve të vlefshme, por ka pasur raste edhe për shkak të ndalesave të ndryshme. Shtetasve të shteteve të BE-se iu është refuzuar hyrja për arsye të mungesës së pasaportave dhe letërnjoftimeve biometrike.

Shtetasve nga shtetet tjera, u është refuzuar hyrja për arsye se nuk kanë pasur viza për të hyre në Kosovë, apo nuk kanë pasur mjete të mjaftueshme për jetesë dhe nuk kanë mundur ta justifikojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit.

4.3.2. Emigrimi i parregullt

Policia Kufitare gjatë vitit 2015 ka i iniciuar 31 raste të kontrabandës me emigrant.

Tabela 4. Rastet e iniciuara nga Policia Kufitare për kontrabandë me Emigrantë

Viti	2013	2014	2015
Numri i rasteve	29	38	31

Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare, Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrim të Dhënave

Nga 31 raste gjithsej, të iniciuara në vitin 2015 nga Policia Kufitare për kontrabandë me emigrantë, janë arrestuar 50 persona (49 me shtetësi kosovare dhe 1 me shtetësi serbe). Po ashtu, nga këto 31 raste, janë trajtuar 69 viktima të kontrabandës me emigrantë.

4.3.3. Trafikimi me qenie njerëzore

Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, vërehet se gjatë periudhës 2013-2015 kemi rritje të numrit të viktimave vendorë të trafikimit, e sidomos grup moshat 15 -17 vjeçare që janë më të cenueshme. Gjithashtu edhe trendët e trafikimit me njerëz sipas shtetësisë gjatë kësaj periudhe kanë ndryshuar dhe janë duke shkuar drejt trafikimit të brendshëm. Tabela e mëposhtme tregon se numri i viktimave të shteteve të huaja në vitin 2013, 2014 dhe 2015 është në rënie në krahasim me vitet e kaluara.

Tabela 5. Viktimat e trafikimit me njerëz sipas shtetësisë, 2013- 2015.

Viti/shtetësia	Kosovarë	Shqiptarë	Serbë	Rumunë	Totali
2013	44	7	1	0	52
2014	36	4	1	1	42
2015	25	4	1	0	30
Totali	105	15	3	1	124

Burimi: DHTQNJ, Policia e Kosovës

Në trendët aktuale të trafikimit në Kosovë kanë ndikuar dy lloj faktorësh:

Faktorët e brendshëm-miratimi i kornizës ligjore dhe të politikave kanë ndikuar që trafikantët të kenë më të vështirë rekrutimin e viktimave nga shtetet tjera dhe transportimin dhe sjelljen e tyre në Kosovë, prandaj në fokus të trafikantëve tashme janë viktimat vendore.

Faktorët e jashtëm– kanë ndikuar në këtë çështje si, për shembull, zgjerimi i Bashkimit Evropian me vendet e lindjes: Rumaninë dhe Bullgarin, pastaj liberalizimi i vizave i vendeve të Ballkanit. Kosova nuk është më vend i preferuar i destinacionit, pasi shtetasit (viktimat potenciale) nga këto vende tashmë lëvizin lirshëm në vendet perëndimore.

Identifikimi i viktimave - Shumica e viktimave të trafikimit identifikohen në lokale nate, bare dhe restorante. Por, janë rritur edhe rastet kur viktimat identifikohen edhe në shtëpi private, apartamente, etj.

Forma e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit në Kosovë, bazuar në rastet e hetuara, statistikat tregojnë se shfrytëzimi për prostitucion të detyruar (shërbime seksuale) është forma kryesore, kurse format e tjera të shfrytëzimit të viktimave si, p.sh.: lypës i detyruar, punë dhe shërbime të detyruara janë më të rralla.

Mosha e re (14-17 vjeç) e viktimave të trafikimit të identifikuar gjatë viteve 2013 - 2015 është brengosëse¹², pasi që vërehet një rritje e ndjeshme e viktimave të moshës së mitur, që përbëjnë shumicën e viktimave të identifikuar. Faktorët që kane ndikuar në rritje e kësaj grup moshe janë: mos kujdesi i duhur prindëror dhe familjar, gjendja ekonomike dhe sociale, braktisja e shkollimit.

DHTQNJ, në bazë të mandatit që ka për Luftimin dhe Parandalimin e Trafikimit me Njerëz gjatë vitit 2015, ka arrestuar 178 persona të dyshuar gjithsej.

Tabela 6. Arrestimet e të dyshuarve sipas veprave penale, 2013-2015

Vepra penale	2013	2014	2015	Totali
Trafikim me njerëz	91	66	59	216
Mundësim i prostitucionit	35	35	37	107
Prostitucion	26	49	70	145
Vepra tjera	30	11	12	53
Totali i arrestimeve	182	161	178	521

Burimi: DHTQNJ, Policia e Kosovës.

Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore gjatë vitit 2015 ka pasur 32 raste të bashkëpunimit policor në shkëmbim informatave dhe verifikim informacioni. Gjithashtu, DHTQNJ, gjatë këtij viti ka zhvilluar 3 raste me hetime të përbashkëta/paralele me këto shtetet: Shqipërinë, Britaninë e Madhe dhe Gjermaninë.

¹²Tabela 9. Viktimat e trafikimit me njerëz sipas grup moshës, 2013 – 2015

5. Kthimi, ripranimi dhe riintegrimi

5.1. Kthimi

5.1.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme është institucion përgjegjës për hartimin e politikave për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Kosovë, si dhe për ri pranimin dhe ri integrimin e shtetasve të saj. Si masë e zbatimit të kthimit, DSHAM-MPB, lëshon *Urdhër Largimi Vullnetar*, përderisa Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë së Kosovës bënë zbatimin e saj. Ndërsa, *Urdhër Largimi* me forcë lëshohet dhe zbatohet nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë së Kosovës. Gjithashtu, në kuadër të MPB-së, nga qershori i vitit 2015 është funksionalizuar Qendra për Mbajtjen e të Huajve, e cila është përgjegjëse për vendosjen dhe mbajtjen e të huajve, të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe për të huajt të cilët konsiderohen që e cenojnë sigurinë publike me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre apo për arsye tjera.

5.1.2. Politikat

Strategjia Kombëtare për Migrim dhe Plan i saj i Veprimit përbëjnë kornizën kryesore strategjike shtetërore me përmbajtje edhe të politikave të kthimit të huajve me qëndrim të paligjshëm në Kosovë si dhe krijimin/konsolidimin e mekanizmave përkatës për zbatimin e tyre. Kthimi është pjesë e objektivit të parë të kësaj strategjie.

Urdhër Largimi Vullnetar është masë administrative nga Ligji për të Huajt, të cilin e lëshon DSHAM-i në formë të vendimit¹³ me kërkesë të DMH-së, ndaj të huajit me qëndrim të paligjshëm me të cilin urdhërohet i huaji që brenda afatit ligjor ta lëshojë territorin e Republikës së Kosovës me ndalës të hyrjes. Nëse largimi shoqërohet me një masë ndaluese, afati i ndalimit të hyrjes, nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) muaj dhe as më i gjatë se pesë (5) vjet.

Në rast mos respektimit të *Urdhër Largimit Vullnetar* si dhe arsyeve tjera sipas nenit 97 të Ligjit për të Huajt dhe UA (MPB) 09 – 2014 Për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, DMH (Sektori për Depërtim) lëshon dhe ekzekuton *Urdhër Largimin* me forcë për të huajin nga territori i Republikës së Kosovës. Afati i ndalimit të hyrjes, nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) muaj dhe as më i gjatë se pesë (5) vjet.

5.1.3. Statistikat

¹³Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Procedurat e Kthimit për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, <http://mpb.rks-gov.net/>

Tabela 6. Numri i Urdhër Largimeve Vullnetare 2011 - 2015

Vepra penale	2011	2012	2013	2014	2015
Urdhër Largimet Vullnetare	389	338	238	59	73

Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

Përveç mos respektimit të Urdhrit për Largim Vullnetar, por edhe rastet e hyrjes dhe qëndrimit te paligjshëm, si dhe në rastet e situatave të tjera të parapara në Ligjin për të Huajt Nr. 04/L-219, Departamenti i Policisë Kufitare - Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, lëshon dhe ekzekuton Urdhër Largim me Forcë. Urdhër i Largimi me Forcë, shoqërohet me ndalim të hyrjes së të huajit në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) muaji deri në pesë (5) vjet. Kjo formë e largimit ka filluar së zbatuari nga fillimi i vitit 2014.

Tabela 7. Numri i Urdhër Largimeve me Forcë 2014 - 2015

Viti	2014	2015
Urdhër Largimet me Forcë	62	60

Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

Gjatë vitit 2015, janë ekzekutuar 60 Urdhër Largime me Forcë ndaj shtetasve të huaj të cilët kanë qëndruar në mënyrë të paligjshme në territorin e Kosovës. Nga 60 Urdhër Largime me Forcë, 44 persona janë shtetas të Shqipërisë, 6 të Indisë, 4 të Bullgarisë, 2 të Kamerunit, 2 të Maqedonisë dhe 1 i Gjermanisë.

Po ashtu, gjatë vitit 2015, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj ka ekzekutuar 45 depërtime me vendim të gjykatave të Kosovës. Nga këto depërtime, 41 persona janë shtetas të Shqipërisë, 2 shtetas të Turqisë, 1 shtetas i Maqedonisë dhe 1 shtetas nga Ukraina.

5.2. Ripranimi

5.2.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim është përgjegjës për koordinimin e procesit të migrimit dhe zhvillimin e politikave të migrimit, për rregullimin dhe kontrollin e migrimit të huajve me qëndrim në Kosovë dhe për përcjelljen e të huajve të cilët janë subjekt i depërtimit apo largimit me forcë në kufirin shtetëror¹⁴. Në kuadër të këtij departamenti, ekziston Divizioni për Ri pranim dhe Kthim - i cili bënë shqyrtimin e kërkesave për ri pranim të shtetasve tanë, të personave të vendeve të treta, ekzekutimin e kërkesave për ri pranim, si dhe kthimin e të huajve në vendin e origjinës në bashkëpunim me institucionet tjera relevante. Mekanizmat tjerë të cilët kontribuojnë në zbatimin e

.....

¹⁴<http://www.mpb-ks.org/?page=1,112> qasja në web faqe 27 maj 2016

politikave të ri pranimit janë të ndërlidhur me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Regjistrim Civil.

5.2.2. Politikat

Ri pranimi si një mekanizëm i rëndësishëm i politikave me qëllim të parandalimit dhe kontrollit të migrimit të parregullt, është avancuar që theksohet në raportet e KE-së për liberalizimin e vizave. DSHAM zbaton kornizën ligjore në fushën e ri pranimit. Ligji nr. 03/L-208, për Ri pranim - përcakton rregullat dhe procedurat për ri pranimin të një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues¹⁵. Zbatimi i legjislationit për ri pranim ka përparësi sa i përket bashkëpunimit për ri pranim me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për ri pranim, kurse me shtetet me të cilat Kosova ka marrëveshje bilaterale për ri pranim, zbatohen marrëveshjet e ri pranimit. Deri më tani, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar gjithsej 23 marrëveshje bilaterale të ri pranimit¹⁶. Zbatimi i marrëveshjeve për ri pranim është një faktor i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt. Një analizë e zbatimit të marrëveshjeve për ri pranim tregon qartë se marrëveshjet e ri pranimit kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit efikas në luftën kundër migrimit të parregullt dhe lehtësimin e largimit të personave që hyjnë/qëndrojnë ilegalisht në territorin e njëres prej palëve.

5.2.3. Statistikat

Viti 2015 është karakterizuar me një rritje të konsiderueshme prej 306% (18 730) të ri pranuar (me forcë 48 % (9040)¹⁷ dhe vullnetar të asistuar nga IOM 52% (9690)¹⁸) të shtetasve të Republikës së Kosovës krahasuar me vitin 2014 (4610). Rritja në vitin 2015 vjen si pasojë e emigrimit të papritur të kosovarëve në drejtim të shteteve evropiane në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015.

Në bazë të dhënave vjetore, sipas strukturës gjinore dhe moshës, nga shtetasit kosovarë të ri pranuar gjatë vitit 2015, 73% janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 27% të gjinisë femërore. Të dhënat tregojnë një rritje shumë të dukshme në përqindjen e femrave nga 20% sa ishin në vitin 2014 në 27% në vitin 2015, por, prapë përqindja më e madhe e të kthyerve 73% janë meshkuj të moshës ndërmjet 18-34 vjeç dhe që kanë qëndruar më pak se gjashtë muaj në shtetet evropiane. Kjo tregon se ata që ri pranohen janë të moshës së re (aktive për punë) kryesisht meshkuj që e kanë lëshuar Kosovën për shkaqe ekonomike dhe sociale.

Për të pasqyruar shkaqet shtytëse të emigrimit të papritur dhe të asistojë politik bërësit t'i përgjigjen sa më mirë nevojave të kthyerve, IOM ka publikuar një studim¹⁹ i cili paraqet shkaqet

¹⁵LIGJI Nr. 03/L-208, PËR RIPRANIM, <http://www.mpb-ks.org/?page=1,169&ddate=2010>, qasja në web faqe 27 maj 2016

¹⁶Marrëveshjet e nënshkuara: Shqipëri, Francë, Zvicër, Gjermani, Danimarkë, Norvegji, Austri, Slloveni, R. Çeke, Belgjikë, Luksemburgu, Holande, Mali i Zi, Suedi, Finlandë, Bullgari, Hungari, Maltë, Estoni, Lihtenshtajn, Kroaci Italia dhe Turqinë.


¹⁷Burimi: MPB

¹⁸Burimi: IOM

¹⁹Një vit me vonë – Eksodusi Kosovar – Faktet dhe mësimet e marra”

shtytëse të emigrimit të pa pritur gjatë fund vitit 2014 dhe fillimit të vitit 2015. Të gjeturat e studimit bazohen në 146 intervista kuantitative të zhvilluara në zyrat e IOM-it, në periudhën 16 tetor 2015 dhe 15 janar 2016, me të kthyerit vullnetarë të gjeturat mund t'i gjeni në si në vijim në faqen 23.

Figura 5. Ri pranimi (vullnetarë dhe me forcë) sipas viteve, 2009 – 2015.



Burimi: PK, IOM (2015 dhe 2016)

Numri më i madh i të ri pranuarve me forcë gjatë vitit 2015, sipas përkatësisë etnike janë shqiptar, me 8230 ose 91%, që në krahasim me vitin 2014 (2658) ka pasur një rritje të konsiderueshme. Për derisa kthimi me forcë i komuniteti RAE, me 8% (699) dhe komunitete tjera me 1% (111), në krahasim me vitin 2014 shënon një zbritje të lehtë.

Sa i përket shpërndarjes etnike të personave të kthyer vullnetar të asistuar nga IOM, në vitin 2015 vërehet një rritje e dukshme në përqindjen e të kthyerve vullnetarë shqiptarë nga 64% në vitin 2014, në 90,0% në vitin 2015 dhe rënie të përqindjes së numrit të kthyerve të komunitetit RAE nga 22% në vitin 2014, në 8,5% në vitin 2015. Kjo pason një trend të përgjithshëm gjatë viteve të fundit me rritje e përqindjes të shqiptarëve të cilët kanë emigruar nga Kosova.

Sipas të dhënave vjetore për vitin 2015, numri më i madh i të ri pranuarve me forcë ishte nga Gjermania 72 % (6545), Zvicra 6% (524), Suedia 5% (418), Austria 4% (371), Hungaria 4% (348), Franca 3% (256) dhe shtetet tjera me 6% (578). Kurse, sipas të dhënave të IOM, numri më i madh i të kthyerve vullnetarë të asistuar vjen nga Gjermania duke përbërë 82% (8 029) të grupit, ndërsa ata nga Austria përfaqësojnë 11 % (1 036), të ndjekur me Belgjikën 1% (118), Hungarinë 1 % (114), Luksemburgun 1% (105), Holandën 1% (102) si dhe një numër më i vogël i të kthyerve nga vende të tjera evropiane, duke përfshirë: Zvicrën, Sllovinë, Republikën Çeke, Finlandën, Norvegjinë dhe Slloveninë.

Sipas një studimi, emigranti kosovar është mashkull mes moshës 20 dhe 39 vjeç, shqiptar me arsim të mesëm dhe i punësuar me kohë të pjesshme ose të plotë për një rrogë mesatare prej 241.00 EUR në muaj.

- Vendimi për migrim është marrë për më pak se një muaj – në disa raste bile edhe për më pak para migrimit, pa njohur gjuhën dhe pa pasur fare njohuri për vendin e destinacionit.
- Burimi kryesor i informacionit për mundësitë për migrim dhe për vendin e destinuar kanë qenë miqtë dhe familja, si në Kosovë ashtu edhe në vendin e destinacionit. Asnjë nuk ka marrë informatë nga burimet zyrtare si ambasadat apo qendrat e shërbimit për migrantë.
- Ata kanë udhëtuar me autobus deri në Serbi, kanë kaluar kufirin më këmbë dhe prej aty kanë udhëtuar me tren ose më autobus deri në shtetin e destinacionit final (87% kanë shkuar në Gjermani).
- Kosovarët e kanë paguar kontrabandistin 900-4000 EUR për person, që ta lehtësojë migrimin e tyre, ose në mënyrë alternative (në disa raste) u kanë dhënë rryshfet policëve në kalimin kufitar në mes të Serbisë dhe Hungarisë.
- Shumica e njerëzve kanë financuar rrugën e tyre të migrimit përmes kredive joformale nga miqtë apo të afërmit ose duke shitur pronë apo pasuri tjetër.
- Përderisa 60% e tyre kanë punuar me kohë të pjesshme apo të plotë, vetëm 9% kanë gjetur punë pas kthimit në Kosovë, në të shumtën e rasteve, sepse pozitat e tyre janë plotësuar me dikë tjetër, ose për të vetë punësuarit, siç janë bujqit e vegjël, sepse ata kanë shitur pajisjet për të financuar migrimin.
- Në vendin e destinacionit, shumica kanë jetuar në qendrat e pranimit të azilkërkuesve dhe pothuajse askush nuk ka mundur të punojë, si në tregun formal ashtu as në atë joformal të punës.
- Shumica e konsideron veten të jetë në pozitë më të keqe financiare se para migrimit. Sidoqoftë, kualiteti i jetës konsiderohet të jetë relativisht i njëjtë me situatën para migrimit dhe në krahasim me të tjerët në komunitet, duke theksuar se migrimi nuk ka ndikuar shumë në statusin e tyre socio-ekonomik.
- Përkundër faktit së gjenden në situatë më të rënduar financiare dhe pritjet e porealizuara gjatë kohës së qëndrimit jashtë, shumica janë të kënaqur (42%), bile edhe shumë të kënaqur (13%) me migrimin e tyre dhe kanë dëshirë të migrojnë sërish.

5.4. Riintegrimi

5.4.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar në kuadër të MPB-së, është përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe menaxhimin e procesit të ri integrimin të personave të riatdhesuar të cilët janë shtetas të Kosovës. Ri integrimi i personave të riatdhesuar konsiston në ri përfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare dhe promovimin e kushteve sociale, ekonomike e politike të tyre.

Në procesin e ri integrimit janë të përfshira shumë institucionet të nivelit qendror dhe lokal që merren me zbatimin e politikave për ri integrimin të personave të riatdhesuar. Nder më të rëndësishmet janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Shëndetësisë (MSH) etj.

Në nivel lokal komunat zhvillojnë ri integrimin e personave të riatdhesuar si bashkëpunim ndër – sektorial, ndërsa Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete është pika e parë e referimit për personat e riatdhesuar, e cila bën koordinimin e aktivitetet me drejtoritë tjera komunale për qëllim të zbatimit të politikave të ri integrimit.

5.4.2. Politikat

Politikat për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar janë të përcaktuara në Strategjinë Nacionale për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar²⁰ dhe Planin e Veprimit²¹, ndërsa institucionet përgjegjëse, kriteret dhe procedurat e ndihmësës dhe të mbështetjes së personave të riatdhesuar gjatë procesit të ri integrimit rregullohen me Rregulloren (QRK) Nr. 08/2015 për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Ri integrimit²², e cila është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 15 maj 2015 dhe legjislacionin relevant në fuqi. Është aprovuar Plani i Integritetit²³ për stafin e Departamentit dhe janë analizuar procedurat aktuale të ndihmës dhe përfitimit me qëllim të hartimit të Planit të modelit standard të shpenzimeve (CSM). Është aprovuar Rregullorja (MPB) 04/2015 për Subvencionimin e Projekteve që promovon.

Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të politikave të ri integrimit gjatë kësaj periudhe, Ministria e Punëve të Brendshme/DRPR, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione vendore dhe ndërkombëtar me qëllim të ofrimit të shërbimeve me të mira për personat e riatdhesuar, si me MASHT – in, Kryqin e Kuq, Nëna Terezë, UNICEF dhe OJQ MONITOR, N.SH. D&D BUSINESS SUPPORT CENTER. Për lehtësimin e zbatimit të politikave të ri integrimit është përgatitur doracaku²⁴ për ri integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare, gjithashtu dhe udhëzuesi për ri integrimet qëndrueshëm²⁵. Janë përgatitur formularët e vlerësimit të nevojave si dhe janë përgatitur formularët standard të monitorimit dhe verifikimit dhe janë shpërndarë në të gjitha komunat. Janë përgatitur dhe shpërndarë Fletëpalosjet Informative²⁶

²⁰[http://www.mpb-](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Riintegrimin_e_Personave_t_e_Riatdhesuar_13032014.pdf)

[ks.org/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Riintegrimin_e_Personave_t_e_Riatdhesuar_13032014.pdf](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Riintegrimin_e_Personave_t_e_Riatdhesuar_13032014.pdf),

²¹http://www.mpb-ks.org/repository/docs/PLANI_I_VEPRIMIT_PER_SRPR_2014_-_2016,_ALB_13032014.pdf

²²http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Rregullore_082015_per_Riintegrimin_e_Personave_te_Riatdhesuar_dhe_Menaxhi.pdf,

²³http://www.mpb-ks.org/repository/docs/PLANI_I_INTEGRITETIT_PER_DRPR_Shqip.pdf

²⁴http://www.mpb-ks.org/repository/docs/25_02_15_101051_The_Handbook.pdf,

²⁵http://www.mpbks.org/repository/docs/Udhzues_per_ndihme_dhe_mbeshtetje_te_personave_te_riatdhesuar_per_riintegrim_te_qendrueshem.pdf

²⁶http://www.mpb-ks.org/repository/docs/fletpalosja_shqip.compressed.pdf,

në të gjitha pikat e qasshme për personat e riadhesuar, në ANP, Qendrën për Akomodim të Përkohshëm shtat ditor dhe në Komuna.

5.4.3. Statistikat

Gjatë vitit 2015, nga Departamenti për Ri integrimin e Personave të Riadhesuar (DRPR) në skemat e ndryshme emergjente dhe të ri integrimit të qëndrueshëm janë mbështetur 2912 persona të ripranuar, shtetas të Republikës së Kosovës dhe i cili numër i përfitueseve është me i lart 30.5% në krahasim me vitin 2014 (2024 persona). Kjo rritje rezulton si rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të DRPR-së, fushatave informuese, verifikimeve në teren, ndryshimeve legislative, nënshkrimit të marrëveshjeve për ofrimin shërbimeve, etj.

Vitin 2015, e ka karakterizuar rritja e përfituesve të kthyer me force për 43.1% (2591) në krahasim me vitin 2014 (1475), ndërsa të kthyerit vullnetar, përveçse nga DRPR-ja, janë mbështetur edhe nga IOM-i dhe organizatat e tjera që zbatojnë projekte të kthimit nga shtetet e BE-së.

Numri më i madh i përfituesve sipas kërkesave të parashtruar për përfitim në DRPR, gjatë vitit 2015, sipas përkatësisë etnike është shqiptarë me 2102 ose 51%, që në krahasim me vitin 2014 (1034), ka pas një rritje të konsiderueshme si rezultat i emigrimit të fundit, ndërsa komuniteti rom, ashkali, egjiptian dhe komunitete e tjera gjatë vitit 2015, kanë pasur një rritje me një përqindje prej 18.2 % (990) në krahasim me vitin 2014 (810).


Ndërsa, sipas komunave të origjinës për vitin 2015, numrin më të madh të përfituesve e kemi nga komuna e Vushtrisë, me gjithsej 10.8 % (315) persona përfitues, duke vazhduar Mitrovica me 9.9 % (288), Podujeva me 8.9 % (258), Prishtina me 8.6 % (250), Gjilani me 7.7 % (225), Gjakova me 6.7 % (194), si dhe me 47.4 % (1382) janë persona përfitues nga komunat e tjera. Sipas shteteve të kthimit, numrin më të madh i përfituesve të kthyer janë nga Gjermania me 72.6 % (2114), pasuar nga Belgjika me 5.1 % (145), Franca me 4.7 % (138), Suedia me 3.8 % (111), Zvicra me 3.2 % (95), Austria me 2.9% (84) si dhe 7.7%(225) janë nga shtetet e tjera.

Programi për Ri integrim, një kujdes më të veçantë ju kushton fëmijëve dhe grupeve të cënueshme, si kategori me e ndjeshme dhe, gjatë vitit 2015, janë mbështetur 78 familje/persona të riadhesuar që i takojnë grupeve të cënueshme. Nga këto grupe kanë përfituar 18 nëna vetushqyese, 25 persona me sëmundje dhe aftësi të kufizuara fizike, 13 persona me aftësi të kufizuara mendore, 7 familje në gjendje të rëndë ekonomike, 5 persona të moshuar pa përkujdesje familjare, 5 familje minoritet në nivel lokal, 3 persona me mungesë të njohurive të gjuhëve zyrtare të Kosovës dhe 2 familje me liri të kufizuar të lëvizjes.

Në vijim gjeni të bashkangjitur mbështetjen e personat/familjet²⁷ të riadhesuar sipas skemave të përfitimit:

.....
²⁷ Një kërkesë e kompletuar që i ka plotësuar kriteret parapara për përfitim nga Programi për Ri integrimi që është aprovuar vendimi nga organet vendimmarrëse të një personi apo familje të ri pranuar mund të jetë përfitues i dy e më shumë skemave të Programit për Ri integrim. Persona përfitues mund të vazhdojnë prej vitit në vit për arsye se


Figura 6. Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit, 2013 – 2015.



Burimi: DRPR/MP

Gjatë vitit 2015, nevoja për transport deri në komunën e origjinës ka vazhduar të ketë ngritje prej 364% më shumë në krahasim me vitin 2014, për shkak të numrit të rritur të ripranuarve. Gjithashtu, numri i të akomoduareve në Qendrën e Akomodimit të përkohshëm në vitin 2015 është më i madh për 20% në krahasim me vitin 2014.

Figura 7. Ndhimja për riintegrim të qëndrueshëm, 2013 - 2015



Burimi: DRPR/MPB

riatdhesohen në periudha të ndryshme kohore dhe vendimi për këta persona fillimisht nga Programi për Ri integrim mbështetet për gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi për gjashtë (6) muaj të tjerë, mirëpo skemat në grafik paraqesin shërbimet e ofruar për personat e riatdhesuar të ri dhe të bartur edhe nga viti paraparak.

Të dhënat e prezantuara më lartë, pasqyrojnë familjet/personat e ri integruar të mbështetur në ri integrimin të qëndrueshëm. Bazuar nga të dhënat e paraqitura, del së gjatë vitit 2015, në fokus ka qenë punësimi i personave të riadhesuar ku, nëse e krahasojmë me vitin 2014, shohim se kemi një rritje të normës nga 4 deri 89 raste.


Të gjithë të kthyerit të asistuar vullnetar përmes IOM-i, përfitojnë nga skemat e Programeve të Asistencës për Ri integrim. Programet e tilla ofrojnë: Informimi i saktë për mundësitë e kthimit, këshillime para nisjes, bileta e udhëtimit, asistencë në aeroport para nisjes nga vendi i destinacionit, në transit dhe pas arritjes në vendin e origjinës si dhe transporti deri në destinacionin e fundit në Kosovë.

Paketa e ri integrimin përfshinë: Asistencë në para të gatshme (70.5%), Asistencë për ri integrim profesional përmes financimit të bizneseve të vogla (18.75%), Asistencë për të siguruar shërbimet mjekësore (1%), Asistencë për akomodim të përkohshme duke përfshirë edhe renovimin dhe rindërtimin e shtëpisë (9%), Trajnime dhe edukim 0,25%), Punësim, Referim (0,5%), etj.

Asistencë e përgjithshme e shpërndarë për të kthyerit e asistuar vullnetar për vitin 2015 kap shumën prej më shumë së një (1) milion euro.

Paketa e ri integrimin për te kthyerit e asistuar vullnetar sipas IOM, 2015

Figura 8. Paketa e riintegrimin për te kthyerit e asistuar vullnetar sipas IOM, 2015



Burimi: IOM

6. Integrimi

6.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Legjislacioni në fuqi garanton të drejtën e fitimit të shtetësisë së Kosovës (përmes natyralizimit) dhe për të cilat kritere duhet të ofrohen shërbime përkatëse me qëllim të lehtësimit të procesit në integrimin në shoqërinë kosovare. Megjithatë, këto shërbime janë të fragmentuara dhe kërkojnë unifikim dhe krijimin e një programi/sistemi qendror për integrimin e të huajve në shoqërinë Kosovare.

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme është autoriteti përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave në çështjet që ndërlidhen me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij departamenti ekziston Divizioni për Shtetësi i cili është përgjegjës dhe vendos për fitimin, humbjen, rifitimin dhe privimin e shtetësisë si dhe vendos për njohjen e statusit të personave pa shtetësi në Republikën e Kosovës.

6.2. Politikat

Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera qendrore dhe lokale dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi është duke punuar në hartimin e Rregullores për integrimin e shtetasve të huaj të cilët kanë qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës. Me këtë draf-rregullore parashihet integrimin i shtetasve të huaj në shoqërinë kosovare dhe të drejtat e tyre gjatë procesit të integrimin.

Politikat për dhënien e shtetësisë së Kosovës janë element i rëndësishëm për administrimin e proceseve të migrimit.

Shtetësia, si një nga të drejtat themelore të njeriut, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në harmoni të plotë me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e cila ka zbatueshme ri të drejtpërdrejtë në Kosovë është e drejtë e garantuar me legjislacionin në fuqi.

Me Ligjin Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, të aprovuar nga Kuvendi në korrik të vitit 2013, përcaktohen mënyrat e fitimit, humbjes, rifitimit si dhe rregullon çështjet që ndërlidhen me shtetësinë. Republika e Kosovës në këtë ligj ka përfshirë edhe dispozita të cilat i lehtësojnë procedurat për natyralizimin e personave me status refugjati dhe personave pa shtetësi në pajtim me konventat ndërkombëtare të miratuara nga OKB-ja në fushën e pa shtetësisë dhe personave me status refugjati, përkundër asaj që Kosova nuk është anëtare e OKB-së.

Përfshirja e këtyre kategorive në legjislacionin e brendshëm, përveç që i ka dhënë efekt nenit 15 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila përcakton që "*çdo kush ka të drejtën e një shtetësie*", është edhe një standard ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut i plotësuar nga Republika e Kosovës.

Shtetësia e Republikës së Kosovës, sipas ligjit fitohet me lindje, me adoptim, me natyralizim, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në bazë të neneve 31 dhe 32, ndërsa humbet me lirim, privim dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Legjislacioni në fuqi, për sa i përket çështjeve që ndërlidhen me shtetësisë në Republikën e Kosovës, është në pajtim me aktet ndërkombëtare që rregullojnë të drejtën e shtetësisë. Ky legjislacion i ofron shtetasve të Kosovës mbrojtje dhe siguri juridike si dhe është instrument dhe faktor i rëndësishëm që kontribuon dhe ndikon në forcimin e sigurinë së brendshme dhe të jashtme të Republikës së Kosovës.


6.3. Statistikat

Divizioni për Shtetësi, në kuadër të DSHAM-it, në vitin 2015 ka pranuar 720 kërkesa nga shtetasit e huaj për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës²⁸. Ku, prej tyre, 187 persona e kanë fituar shtetësinë, ndërsa 660 kërkesa janë refuzuar për mos plotësimin e kriterëve ligjore. Krahasimi i të dhënave të viteve 2014/2015 tregon se në vitin 2015 ka një rritje të vendimeve pozitive prej 9.3% dhe të vendimeve negative prej 28%.

Me kërkesa për fitimin e shtetësisë së Kosovës prijnë shtetasit e huaj nga Serbia me 34.2% (247), pasuar nga shtetasit e Turqisë me 19.4% (140), Shqipëria me 12.2% (88), Maqedonia me 12% (87), personat me origjinë nga Kosova, të cilët me kërkesë të tyre janë liruar nga shtetësia e Kosovës dhe kanë aplikuar për rifitim të shtetësisë me 5.4%(39) si dhe nga shtetet e tjera me 16.6% (120). Nga 187 personat, të cilët kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, 37.4% (70) janë nga Serbia, 12.3% (23) nga Shqipëria, 11,7% (22) nga Kosova, 11.2% (21) nga Maqedonia dhe 27.2% (51) nga shtetet e tjera. Personat të cilët kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës sipas grup moshave: 49.2% (92) i përkasin grup moshës 18-34 vjeç, 36.9% (69) grup moshës 35-64 vjeç dhe 13.4% (26) grup moshave të tjera.

.....
²⁸ *Fitimi i shtetësisë kryesisht është dhënë duke u bazuar në nenet 31 dhe 32 të Ligjit për Shtetësi Nr. 04/L-215*

Figura 9. Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës sipas gjinisë, 2013-2015



Burimi: DSHAM/MPB

Gjatë tre vjetëve të fundit, trendët e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës tregojnë një tendence në rritje. Gjatë vitit 2014, në aspekt të fitimit të shtetësisë, gjinia femërore ka dominuar dukshëm ndaj gjinisë mashkullore, ndërsa në vitin 2013 dhe 2015 ka qenë në proporcion.

7. Migrimi dhe zhvillimi

7.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm ekonomik si faktor kryesor që ndikon në proceset migruese. Nisur nga fakti së Kosova ka një diasporë relativisht të madhe (rreth 800.000), rol kryesor në këtë fushë ka Ministria e Diasporës. Krahas saj, edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik²⁹, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë³⁰, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave³¹ në fushëveprimin e tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive të cilat direkt apo indirekt rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me migrimin dhe zhvillimin.

Qëllimi i përbashkët është krijimi i një klime të favorshme për promovimin dhe tërheqjen e investimeve nga diaspora.

7.2. Politikat

Ministria e Diasporës³², për të arritur misionin e saj për mbështetjen e diasporës, ka hartuar *Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën 2013 – 2018*, si dhe *Planin e Veprimet*. Përveç kësaj Strategjie, diaspora si potencial për zhvillimin ekonomik të vendit është inkorporuar në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021*³³.

Vlen të theksohet se, si shtyllë kryesore e angazhimit janë aktivitetet në themelimin dhe bashkëpunimin me rrjetin e bizneseve në vendet ku jeton dhe vepron diaspora (17 rrjete të themeluara, me mbi 5300 biznese).

Fushata “*Ti je pjesë e atdheut*” është vazhdim i procesit të regjistrimit të diasporës, proces i cili ka filluar në fund të vitit 2013 dhe vazhdon deri në fund të vitit 2017 (regjistrimi elektronik dhe përmes formularëve). Kjo fushatë është hapur në qershor të vitit 2015 dhe deri në fund të vitit 2015 janë regjistruar mbi 200,000 pjesëtarë të diasporës.

Regjistrimi do të vazhdojë edhe pas vitit 2017 vetëm në formë elektronike (on-line) në linkun: [http://rd.rks-gov.net/\(S\(fptnd4m00cnolbvzfgon5pet\)\)/Home.aspx](http://rd.rks-gov.net/(S(fptnd4m00cnolbvzfgon5pet))/Home.aspx)

Janë duke u bërë përpjekje të vazhdueshme përmirësimit e mëtejshëm të organizmit të shkollimit në gjuhën shqipe për diasporën.

²⁹ <http://www.mzhe-ks.net/>

³⁰ <http://www.mti-ks.org/>

³¹ <http://mf.rks-gov.net>

³² <http://med.rks-gov.net>

³³ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në kuadër të politikave zhvillimore, me Strategjinë për Zhvillim të Sektorit Privat 2013-2017, si dhe Ligjin për Investimet e Huaja Nr. 04/L-220,³⁴ ka rol mbështetës dhe kontribuon në mënyrë indirekte në fushën e migracionit. Raporti i të bërit biznes të Bankës Botërore 2015, tregon se Kosova ka bërë progres në lehtësimin e bërjes biznes, ku është ranguar në vendin e 75.³⁵ Si rezultat, bizneset me *Pronar të Huaj*, në vitin 2015 kanë shënuar një ngritje rreth 310% në krahasim me vitin 2014, pra, nga 149 biznese të regjistruara në vitin 2014 kemi rritje në 475 në vitin 2015.

MPMS, përkundër sfidës së papunësisë, mbetet e përkushtuar për vazhdimin e politikave ekzistuese që kanë të bëjnë me reformimin dhe modernizimin e shërbimeve publike të punësimit. Ndërkaq, Ministria e Financave, me *Reformën Fiskale* si dhe masat e parapara në *Programin e Reformave Ekonomike*, synon përmirësimin e klimës investuese si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik si parakushte për rritjen e punësimit e me këtë edhe parandalimin e emigrimit jo të rregullt.

7.3. Statistikat

Dërgesat e emigrantëve (Remitancat)

Dërgesat e emigrantëve në Kosovë gjatë pesë vjetëve të fundit kishin një mesatare prej 650 milionë euro në baza vjetore. Në vitin 2015, remitencat në Kosovë arritën shumën prej 752.4 milionë euro, që krahasuar me vitin 2014 paraqet rritje prej 8.1%. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2015 kanë pasur pjesëmarrje prej 13% në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Rëndësia e theksuar makroekonomike e remitancave shihet edhe nga fakti që mbulojnë më shumë se 40% të deficitit tregtar të Kosovës.

Figura 9. Remitancat si përqindje e PBB-së dhe deficitit të bilancit tregtar, 2006-2015



Burimi: BQK

³⁴ [http://www.mti-ks.org/repository/docs/LIGJI_Nr._04-L-220_PER_INVESTIMET_E_HUAJA_\(shqip\)_982171.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/LIGJI_Nr._04-L-220_PER_INVESTIMET_E_HUAJA_(shqip)_982171.pdf)


³⁵ <http://www.doingbusiness.org/~media/GIAWB/Doing%20Business/Documents/Annual-Reports/English/DB15-Full-Report.pdf>

Sa i përket kanaleve të dërgimit të parave, rreth 67% e dërgesave të emigrantëve transferohen përmes sistemit bankar, që tregon avancimin në këtë fushë, ndërsa pjesa tjetër përfshinë dërgesat e emigrantëve në mallra, si dhe mjetet që transferohen përmes kanaleve joformale. Burim kryesor i dërgesave të emigrantëve vazhdojnë të jenë vendet e BE-së dhe zonës Schengen (Gjermania dhe Zvicra me 36.7% dhe 23%, të dërgesave gjithsej të pranuar në Kosovë).

Investimet e huaja direkt

Investimet e huaja direkt (IHD) në Kosovë gjatë vitit 2015 ishin 324.4 milionë euro, apo 173.24 milionë euro më shumë krahasuar me vitin paraprak. Gjatë periudhës 2008 – 2011, IHD në Kosovë kanë mbajtur një nivel të ngjashëm në raport me PBB-së (në mesatare rreth 8.3%), mirëpo, ky trend i cili shënoi një rënie gjatë periudhës 2012 – 2014 (në mesatare rreth 4.1%) pati rritje të dukshme në vitin 2015. Rritja e vlerës së IHD-ve gjatë vitit 2015 është rezultat i fluksit më të lartë të hyrjes së IHD-ve, si atyre të pranuar në formë të kapitalit aksionar, po ashtu edhe në instrumente të borxhit. Konkretisht, investimet në kapital aksionar janë rritur për 127.4 milionë euro në vitin 2015, ndërsa kreditë ndërmjet ndërmarrjeve (instrumente borxhi) janë rritur për 46.4 milionë euro. Vlen për t'u theksuar që dallimi kaq i lartë me vitin paraprak është edhe për faktin se viti 2014 ishte karakterizuar me "kosovarizimin" e disa kompanive me kapital të huaj (shitja e aksioneve nga ana e aksionarëve të huaj tek sipërmarrësit vendor) si dhe shpërndarjes së super-dividendës nga disa kompani.

Figura 10. Investimet e huaja direkt në Kosovë (mil.€) dhe % e PBV-së.



Burimi: BQK

IHD-të në Kosovë, gjatë vitit 2015, kryesisht janë përqendruar në patundshmëri duke arritur vlerën prej 189.6 milionë euro apo 28.7%, rritje krahasuar me vitin paraprak. Sektori financiar dhe ai i ndërtimit kanë shënuar rritje gjithashtu. Konkretisht sektori financiar pati rritje prej 40.1% duke arritur vlerën 64.3 milionë në vitin 2015, përderisa ishte 41.9 milionë në vitin 2014, kurse sektori i ndërtimit pati rritje të theksuar duke arritur vlerën 46.3 milionë nga vlera negative prej 19.9 milionëve që pati në vitin 2014.

Vendet e Bashkimi Evropian dhe zonës Schengen edhe gjatë vitit 2015 kanë luajtur një rol të rëndësishëm në nivelin e IHD-ve në Kosovë. Prej tyre më të rëndësishmet ishin Zvicra, Gjermania dhe Austria. Burimi i kryesor i IHD-ve në Kosovë gjatë vitit 2015 ishte Zvicra me 18.5 milionë. Për dallim nga viti paraprak, IHD-të nga Britania e Madhe dhe Turqia gjatë vitit 2015 kanë shënuar rritje.

Migrimi qarkor

Kategoria më e madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave parësore vazhdon të jetë kompensimi i punonjësve³⁶, e cila gjatë vitit 2015 kishte një bilanc prej 205.7 milionë euro (200.4 milionë euro gjatë vitit 2014). Punonjësit kosovarë që punojnë jashtë vendit përfshijnë punëtorët sezonal dhe punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendren e interesit ekonomik (shpenzimet) e kanë në Kosovë, ndërsa punojnë jashtë vendit dhe për punën që bëjnë paguhen nga ekonomitë jo rezidentë. Pjesën më të madhe të pranimeve nga kompensimet e punonjësve e përbëjnë pranimet nga punëtorët sezonal që punojnë në Afganistan dhe në Irak.

.....
³⁶ *Kompensimi i punëtorëve përfshinë pagat dhe përfitimet tjera që paguhen nga ndërmarrjet jo rezidente për punonjësit kosovarë që punojnë jashtë vendit dhe anasjelltas.*

8. Azili dhe mbrojtja ndërkombëtare

8.1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse

Autoritetet shtetërore përgjegjëse në fushën e azilit në Kosovë janë: Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion³⁷, Komisionin Kombëtar për Refugjatë, Gjykata kompetente si dhe Policia e Kosovës. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, është institucioni kryesor për shqyrtimin e kërkesave për azil, vendimmarrjen në shkallë të parë si dhe pranimin dhe akomodimin e azilkërkuësve në Qendrën e Azilit. Komisioni Kombëtar për Refugjatë është shkalla e dytë në procedurën administrative, ndërsa gjykatat kompetente vendosin lidhur me ankesat.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare mbështetëse, MPB-ja ka vazhduar bashkëpunimin me UNHCR sipas Marrëveshjes Teknike³⁸ të nënshkruar në mes të MPB-së dhe UNHCR-it.

8.2. Politikat

Kosova është e vendosur për zhvillimin dhe fuqizimin e politikave dhe praktikave të azilit lidhur me përcaktimin e statusit të refugjatit dhe mbrojtjen e personave në nevojë, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Për rrjedhojë, koordinimi ndërmjet institucioneve që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të huajve që kërkojnë mbrojtje në Kosovë është esencial³⁹.

Republika e Kosovës, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ka hartuar Planin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në kuadër të së cilës është paraparë ndryshimi-plotësim i Ligjit për Azil me qëllim të harmonizimit me Direktivat e BE-së⁴⁰.

Kosova ka bashkëpunimi të ngushtë edhe me organizatat tjera të përfshira në çështje të Azilit si UNHCR-në dhe organizatat tjera zbatuese të programeve të UNHCR-së si CRPK (civil right Programs), KRCT (Kosovo Rehabilitation Center for Torture), si dhe me IOM-in dhe të tjera. Më 10 qershor 2015, Republika e Kosovës është anëtarësuar si pjesëmarrëse me të drejta të plota në Iniciativën Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjate "MARRI".

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të së drejtës për të kërkuar azil, të drejtave të ankimit, respektimit të afateve dhe fuqizimit të pavarësisë së vendimmarrjes në shkallën e parë dhe të dytë, si dhe ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për azil lidhur me marrjen e

³⁷ Ligji nr. 04/L-217 për Azil

³⁸ Bashkëpunimin për të Lehtësuar Qasjen e Personave në Nevojë për Mbrojtje Ndërkombëtare në Territorin e Kosovës dhe në Procedurat e Azilit

³⁹ Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, faqe 29, <http://www.mpb-ks.org/?page=1,114&ddate=2013, qasja ne faqe 03.06.2016>


⁴⁰ Direktivat 2001/55/KE, 2003/86/KE, 2013/33/BE, 2013/32/BE, 2011/95/BE, 2011/51/BE.

informatave për vendin e origjinës, teknikat e intervistave, si dhe përmirësimin e kualitetit të vendimmarrjes.

8.3. Statistikat

Numri i azilkërkuesve gjatë vitit 2015 (70), megjithatë, nuk është i lartë dhe ka qenë në rënie për - 33.3% krahasuar me vitin 2014 (105). Nga një anë, rënia e numrit të azilkërkuesve në vitin 2015 ka të bëjë me ndërmarrjen e masave për parandalimin e lëvizjes të azilkërkuesve nga shtetet e rajonit të afektuar nga ky fenomen, kurse nga ana tjetër, supozohet që territori i Republikës së Kosovës nuk përkonte me korridoret e lëvizjes dhe depërtimit më të lehtë të azilkërkuesve kah shtetet perëndimore.

Figura 11. Azilkërkuesit në Kosovë sipas viteve, 2009 - 2015



Burimi: DSHAM/MPB

Sipas statusit të vendimeve: Ndërprerja e procedurës – 66, Vendimi pozitiv mbrojtje plotësuese - 2 , Refuzimi i kërkesës – 2 (numri i vogël i vendimeve pozitive është si pasojë e largimit të azilkërkuesve nga Kosova (mesatarisht 6 ditë qëndrim në Qendër). Sipas gjinisë, 56 (82,0%) meshkuj, dhe 14 (18,0%) femra, kurse, sipas grup moshës, grup moshë më e përfaqësuar është “18-34 vjeç” dhe atë me 60%, kurse grup moshë “35-64 vjeç” përfaqësohet me 21,5 %. Përfaqësimi i lartë i grup moshës “18-34 vjeç”, si grup moshë aktive, sipas të dhënave mbështetet në faktin që personat në këtë moshë më së shumti ishin të nënshtruar presionit nga ana e grupeve të ndryshme ushtarake që të marrin pjesë aktive në zonat e luftës në vendet nga vijnë, por edhe për shkak të përparësisë eventuale të tyre për ta fituar statusin e azilantit apo ndonjë punë në shtetet perëndimore.

Vendet kryesore të origjinës së azilkërkuesve në Kosovë janë: Siria - 58 (83,0%), Iraku - 6 (8,6%), kurse shtetet tjera janë të përfaqësuara me gjithsej - 6 (8,4%) azilkërkues.

9. Shtojcat

Tabela 8. Bashkëpunimi ndërkombëtar policor lidhur me hetimin e trafikimit me njerëz, shkëmbimi i informatave, ndihma juridike ndërkombëtare, 2013 – 2015.

Viti	Shqipëri	Serbi	Mali i zi	Austri	Zvicër	Gjermani	Britania e madhe	Suedi	Belgjikë	Itali	Moldavi	Tjera	Gjithsej
2013	5	2	1	1	2	0	2	2	1	1	2	1	20
2014	9	2	1	1	2	1	0	0	2	1	2	6	27
2015	14	2	3	0	2	1	4	1	0	1	0	4	32
2016	28	6	5	2	6	2	6	3	3	3	4	11	79

Burimi: DHTQNJ, Policia e Kosovës

Tabela 9. Viktimat e trafikimit me njerëz sipas grup moshës, 2013 – 2015

Viti/Grup-mosha	14--17	18--22	23--25	26--30	31--35	36--40	41-50	Gjithsej
2013	24	13	5	6	2	1	1	52
2014	18	11	3	6	2	1	1	42
2015	14	8	2	5	1	0	0	30
Total	56	32	10	17	5	2	2	124

Burimi: DHTQNJ, Policia e Kosovës

Tabela 10. Dërgesat e diasporës sipas shteteve kryesore dhe viteve në përqindje 2008-2015

Viti	Përshkrimi	Gjithsej	Gjermania	Zvicra	Italia	Austria	Belgjika	SHBA	Suedia	Franca	Norvegjia	Kroacia	Britania e madhe
2008	100	37.7	15.9	13.1	6.2	2.8	2.8	3.7	3.9	1.9	2.2	1.5	8.3
2009	100	37.4	21.1	10.3	5.7	3.1	2.8	3.2	3.8	2.7	1.8	1.3	6.7
2010	100	34.2	21.2	7.7	5.4	2.7	4.1	3.3	3.8	2.8	1.9	1.5	11.4
2011	100	33.2	23.1	7.0	5.5	2.6	3.7	3.5	3.9	2.7	1.8	1.4	11.6
2012	100	34.3	23.4	7.4	6.1	3.4	4.5	2.7	2.4	2.8	1.0	2.2	9.7
2013	100	33.4	23.5	10.0	5.4	2.2	4.5	2.8	3.4	2.5	1.2	2.4	8.8
2014	100	36.4	22.5	5.0	3.8	2.6	6.2	2.9	3.3	3.2	1.3	3.1	9.7
2015	100	36.7	22.4	4.8	3.5	2.5	8.0	2.9	3.1	2.7	2.0	2.9	8.5

Burimi: BQK

Personat e zhvendosur ndërmjet janarit 1998 dhe në fund të marsit 2004 brenda Kosovës dhe në rajon (Serbi, Mali i zi, Maqedoni)

Ministria për Komunitete dhe Kthim, në bazë të mandatit të saj në vazhdimësi ka ndërmarr aktivitetet e realizimit të projekteve të kthimit, si dhe ka bërë subvencionimin-financimin e projekteve të cilat kanë për bazë dialogun, riintegrimin dhe zhvillimin e një shoqërie shumë-etnike.

Tabela 11. Numrin i kthimit vullnetar sipas viteve 2014 - 2015

Kthimet vullnetare te zhvendosurve brenda Kosovës dhe nga rajoni	2014	2015
Shqiptar	50	20
Ashkali/ Egjiptian	151	221
Boshnjak	9	18
Kroat	0	0
Goran	21	23
Malazez	1	3
Rom	55	85
Serb	398	429
Turk	0	3
Total	685	802

Burimi: UNHCR- Kosovë

Shtëpitë e ndërtuara gjatë periudhës 2014 dhe 2015 – Ministria për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2014 ka ndërtuar 37 shtëpi, ndërsa në bashkëfinancim me BE dhe Ambasadën Britanike 31 shtëpi, për të kthyerit vullnetar. Gjatë vitit 2015, mbështetja financiare për nismat për kthim dhe ri integrim kanë vazhduar. Kështu, 134 familje të zhvendosura kanë përfituar mbështetje në ndërtim të shtëpive, pako ushqimore dhe higjienike, orendi dhe pajisje shtëpiake, dhe grande për gjenerimin e të ardhurave. Gjatë vitit 2015, ka pas ngritje gati të dyfishtë të ndërtimit të shtëpive për të kthyerit vullnetar krahasuar me vitin 2014 (68 shtëpi).

Qendrat kolektive - Sipas të dhënave të UNHCR-së numër i konsiderueshëm i të zhvendosurve vazhdon të jetojë në qendra kolektive, përkatësisht 610 individë në vitin 2014, përkatësisht 504 në vitin 2015

Tabela 12. Qendrat kolektive në Kosovë 2014 - 2015

Regjionet	2014			2015		
	Qendrat kolektive	Familje	Individ	Qendrat Kolektive	Familje	Individ
Mitrovicë	22	112	237	18	98	206
Gjilan	6	120	314	5	102	247
Prishtinë	6	36	59	5	31	51
Gjithsej	34	268	610	28	231	504

Burimi: UNHCR Kosove